

157519

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E KRETHIT TIRANE  
NR. 1570

V E N D I M

PER RIREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me datë 11.02.1994 une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane DONIKA DETI, si shqyrtova kerkesen e kerkuesit Luan Kuci, i cili kerkon te riregjistroje Shoqerine e Perbashket GENERAL INVEST ne formen e nje shoqerie me pernjegjesi te kufizuar e quajtur "GENERAL INVEST" si person juridik dhe;

K O N S T A T O V A :

Kerkesa e kerkuesit Luan Kuci per riregjistrimin si person juridik te shoqerise se perbashket GENERAL INVEST ne formen e nje shoqerie me pernjegjesi te kufizuar "GENERAL INVEST" SH.P.K., me ortak Ndermarrjen e Ushqimit Social nr.3 perfaqesuar nga z.Mimoza Lengo dhe firmes angleze CARRIGLEGAN LIMITED z. Sonia Maya Castro, me administrator Luan Kuci, me kapital 82.181 dollare USD, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me seli ne Tirane dhe me objekt veprimitarie ne fushen e sherbimeve tregtare per rikonstruksionin dhe venien ne pune te objektin tre katesh ne rrugen e "BARRIKADAVE", tregtimin e mallrave te ndryshme ushqimore e industriale, me shumice e pakice, veshmbathje, pije alkoolike, freskuese, makineri e pajisje.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE:

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", si dhe ligji 7667, dt. 28.01.93

V E N D O S A :

Riregjistrimin si person juridik te shoqerise se perbashket GENERAL INVEST ne formen e nje shoqerie me pernjegjesi te kufizuar "GENERAL INVEST" SH.P.K., me ortak Ndermarrjen e Ushqimit Social nr.3 perfaqesuar nga z.Mimoza Lengo dhe firmes angleze CARRIGLEGAN LIMITED z. Sonia Maya Castro, me administrator Luan Kuci, me kapital 82.181 dollare USD, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me seli ne Tirane dhe me objekt veprimitarie ne fushen e sherbimeve tregtare per rikonstruksionin dhe venien ne pune te objektin tre katesh ne rrugen e "BARRIKADAVE", tregtimin e mallrave te ndryshme ushqimore e industriale, me shumice e pakice, veshmbathje, pije alkoolike, freskuese, makineri e pajisje.

Kunder vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte.

G J Y Q T A R E  
/DONIKA DETI/



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE**

Nr. \_\_\_\_\_ Regj.

**V E N D I M**

"I Gjyqtarit te vetem"

Sot, më datën 12.09.1996, unë Klara Kukull, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Tiranë, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paracitur nga ortaku dhe President i Keshillit Administrativ te Shoqërisë Tregtare "GENERAL INVEST" Sh.P.K.,

**K O N S T A T O V A**

Se, Shoqeria Tregtare "GENERAL INVEST" SH.P.K. vepron si person juridik ne baze te Vendimit Nr.1575, date 11.02.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane. Me vendim eshte vendosur qe ne perberje te Keshillit Administrativ, si organi administrues i kesaj Shoqerie, te jene Vebi Velija dhe zonja Margarita Lamani. President i Keshillit Administrativ te jete Vebi Velija.

Po keshtu eshte kerkuar qe ne dokumentet e kesaj Shoqerie te korrigohen:

a) shifra e kapitalit themeltar te Shoqerise "General Invest" Sh.P.K. nga 82.181 \$ USA, qe eshte ne vendimin e riregjistrimit, ne "205.452 \$ (dyqindepesemjekaterqindepesedhjetedy dollare USA) nga te cilat 82.181 \$ (tetehjetedyminjenjeqindetetedhjetenje dollare USA) NTUS 3 dhe 123.271 \$ (njeqindjenjezetur tredimi qindeshtatedhjetenje dollare USA) "CARRIGLEGAN LIMITED" Sh.P.K.", siç eshte realisht ne dokumentet e Shoqerise.

b) organi administrativ i Shoqerise nga nje administrator, qe eshte ne Vendim, ne Keshill Administrativ, qe perbehet nga Vebi Velija dhe zonja Margarita Lamani, ku si President i Keshillit Administrativ eshte Vebi Velija, i cili edhe ka paraqitur ne gjykate kerkesen per depozitim e ndryshimit si dhe per pasqyrimin e tij ne Registrin Tregtar si dhe kerkesen per korrigimin e gabimeve ne kapitalin themeltar te Shoqerise dhe ne organin administrues te saj.

Ne baze te Ligjit Nr.7638, date 19.12.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe Ligjit Nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" çmoj se kerkesa per depozitim e ndryshimeve ne aktet e Shoqerise "General Invest" Sh.P.K. dhe korrigimin e gabimeve eshte e drejtë dhe duhet pranuar.

Per keto aresye;

Ne baze te nenit 33 te Ligjit Nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare";

**V E N D O S A :**

1. Pranimin e kerkeses dhe depozitimin ne Regjistrin Tregtar te ndryshimeve ne Shoqerine Tregtare "**GENERAL INVEST**" Sh.P.K., duke bere shenimin ne fleten perkatese te regjistrat, ne kolonen Nr. 3, me numer rendor 2, duke u ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

2. Korrigimin e gabimit ne Vendimin e riregjistrimit te Shoqerise me Nr. 1575, date 11.02.1994 dhe konkretisht:

a) kapitali themeltar i Shoqerise "General Invest" Sh.P.K. eshte "205.452 \$ (dyqindepesemijekaterqindepesedhjetedy dollare USA) nga te cilat 82.181 \$ (tetedhjetedy mijenje qindetetedhjetenje dollare USA) NTUS 3 dhe 123.271 \$ (njeqindenje zetetremi jedyqindeshtatedhjetenje dollare USA) "CARRIGLEGAN LIMITED" Sh.P.K."

b) organi administrativ i Shoqerise "General Invest" Sh.P.K. eshte Keshilli Administrativ, qe perbehet nga Vebi Velija dhe zonja Margarita Lamani, ku si President i Keshillit Administrativ eshte Vebi Velija.

Per keto te behet prishja me nenvizim dhe shenimi ne fleten perkatese te regjistrat, ne kolonen Nr.2 dhe 3.

G J Y Q T A R E  
  
Atteve Me Rrug  
H.S.

K O N T R A T E

E

SHOQERISE SE PERBASHKET SHQIPTARO-IRLANDEZE PER  
VEPRIMTARI EKONOMIKO-TREGTARE NE SHQIPERI. (SH.P.K.)

Ndermjet Ndermarrjes Tregtare te Ushqimit Social Nr 3, person juridik me seli ne Tirane, Republika e Shqiperise, qe vepron ne baze te legjistacionit shqiptar, perfa- gesuar me prokure te per gjithshme nga drejtoresha Pellumbesha Ago dhe firmes "CARRIGLEGAN LIMITED" 17 Dame Street Dublin 2.

Palet u morren vesh per sa vijon:

NENI 1

Te krijojne nje Shoqeri te Perbashket Shqiptaro-Irlandeze per te ushtruar veprimtari ekonomiko-trege- tare, e cila me poshte do te quhet Shoqeri me emertim:

- Ne shqip "GENERAL INVEST"
- Ne anglisht "GENERAL INVEST"

NENI 2

Shoqeria eshte person juridik. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave te legjistacionit shqiptar sipas kesaj kontrate dhe statutit te saj, qe i bashkelidhen ke- saj kontrate dhe jane pjesa perberese te saj. Shoqeria nuk per gjigjet vetem me pasurine e saj dhe ne asnjë rast nuk per gjigjet per detyrimet e Ortakeve.

Gjithashtu Ortaket nuk per gjigjen persona- lisht per detyrimet e shoqerise dhe nuk ngarkohen per detyrimet tej kuotes se tyre. Shoqeria nuk per gjigjet per detyrimet e shtetit shqiptar dhe anasjelltas.

O B J E K T I

NENI 3

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj ekonomiko-tregetare kryesisht fushen e sherbimeve tregtare per rikonstrukcionin e rrjetit tregtar ekzistues dhe ngritjen e objekteve te rinj. Ajo do te zhvilloje ne Tirane dhe rrethe te tjera te vendit rikonstrukcionin e objekteve tregtare, ngritjen e tyre ne nje kategori te larte, tregtimin e mallrave te konsumit te gjer perfshire eksport-importin e trankaksione mallrash, sipas kerkeses se tregut shqiptar e te huaj, por mund te kryej ne qoftese ka fitim dhe veprimitari te tjera.

Fillimisht Shoqeria do te beje ndertimin, kompletimin e venien ne pune te objektit tre katesh ne rrigen e "Bashkimi i Konservatorëve" ne Tirane.

NENI 4

  
Kapitali themelor i Shoqerise : eshte caktuar ne dollare 205452\$USD.

Ortaket marrin pjese ne kapitalin themelor ne pjese si vijon:

- Ortaku shqiptar do te vere ne dispozicion te ndermarries 82181\$USD qe do te behen edhe nga kunder vlefta e nderteses qe do te vihen ne dispozicion, sipas llogarive perkatese.

- Ortaku i huaj do te vere ne dispozicion te ndermarrjes 123271\$USD ose paisje e lende te pare per objektin e mesiperm.

Vleresimi i kuotave ne natyre do te behet ne marreveshje te perbashket nga ortaket.

Kuotat e mesiperme do te jene ne monedhe shqiptare ne perputhje me rregullat e percaktuara nga Ministria e Financave te Republikes se Shqiperise dhe me kursin zyrtar te Bankes se Shtetit Shqiptar te Republikes se Shqiperise.

Duke marre parasysh kuotat e dhena perkatesish nga ortaket per krijimin e kapitalit themelor te Shoqerise.. Ndermarja Tregetare e Ushqimit Social Nr 3 do te kete 40% te kapitalit themelor dhe firma e huaj do te kete 60% te kapitalit te mesiperme.

Derdhja e kuotave ne dollar nga ortaket per krijimin e kapitalit themelor te Shoqerise do te behet brenda 30 diteve pas marrjes se Autorizimit perkates per krijimin e Shoqerise nga Keshilli i Ministrave te Republikes se Shqiperise.

NENI 5

Likuiditetet dhe transaksionet financiare do te shenohen ne Banken e Shtetit Shqiptar, ku shoqeria do te hape llogarive rrjedhese te nevojeshme. Per kapitalin themelor ne Shoqerini do te hapet libri i llogarive, ku do te shenohen kuotat e secilit ortak.

NENI 6

Shoqeria e fillon veprimtararine e saj pas marrjes se autorizimit nga organi kompetent shqipetar, sipas kerkimes qe do ti paraqes ortaku shqipetar dhe rregjistrimit te saj ne organet perkatese.

Fitimet e realizuara nga Shoqeria , pas shlyerjes se detyrimeve ligjore , zbritjes se fondeve rezerve , etj do ti nenshtrohen nje takse ne masen qe caktohet nga Ministria e Financave e Republikes se Shqiperise , ne perputhje me legjispcionin shqiptar.

Fitimi qe mbetet do te ndahet midis ortakeve, perpjestimisht me kuotat e derdhura nga secili ne kapitalin themelor.Pjesa e fitimeve neto qe i takon prakut te huaj , sipas marveshjes se paleve , do te perdoret dhe per investime per zgjerrimin e veprimtarise se Shoqerise si dhe per investime te tjera te percaktuara ne objektin e kontrates.

NENI 7

Veprimtaria ekonomike e Shoqerise dhe investimet e ortakeve te huaj mbrohen nga shteti shqiptar, i cili i si-guron Shoqerise te njejtat kushte qe parashikohen per personat e tjera juridik shqiptar.

DETYSRIMET E ORTAKUT TE HUAJ

NENI 8

Ortaku i huaj detyrohet ti jape Shoqerise dokumentacionin e plete teknik dhe teknologjiine fdhe te siguroje bashke me ortakun shqiptar realizimin e tyre, te marre pjese ne organizimin dhe drejtimin e veprimtarise ekonomiko-tregtare dhe ti Shoqerise pajisjet dhe materialet sipas listes Nrl e boshkëlidhur, perfshire shkollimin e personelit.

Ortaku i huaj merr persiper shpenzimet ne valut te te huaj .

DETYSRIMET E ORTAKEVE SHQIPETAR

NENI 9

Ortaket shiptar detyrohen t'i japin Shoqeris ndertesen, materialet , fuqine punetore, personelin teknik dhe administrativ, te japin kontributin e tyre per te furnizuar shoqerine me lendet e nevojeshme per rikonstrukcionin sipas programit te rikonstrukzionit etj.

ORGANET E SHOQERISE

NENI 10

Organet e Shoqerise se perbashket jane:

- Asambleja e ortakeve
- Organi administrativ

Modelitetet e formimit dhe te funksionimit te tyre percaktohen ne statutin e Shoqerise.

12

Brenda tre javeve te rregjistrimit te Shoqeri-  
- se ne Ministrine e Financave te Republikes se Shqiperise, duhet  
te mblidhet Asambleja e Ortakeve ne seline e Shoqerise per te ca  
-ktuar detyrimet perkatese.

NENI 11

Ortaket detyrohen te ruajne karakterin e fshe  
-hte te dokumentacionit, te informatave, te njojurive dhe te per-  
vojes se shkembyer dhe te realizuar ne kuadrin e Shoqerise, dhe te  
marrin te gjitha masat e nevojeshme per te shmangur perhapjen e  
tyre, qofte edhe pjeserisht.

VLEFSHMERIA E KONTRATES

NENI 12

A  
Ortaket kane te drejte te heqin dore nga Shoq  
-eria duke i ua ofruar kuoten e tyre me opson ortakeve te tjere  
dhe tua cedojne te treteve kur ortaket nuk do te ushtrojne te dre  
-jten e opsonit.

NENI 13

Mosmarveshjet qe mund te lindin midis paleve  
dhe nuk mund te zgjidhen me bisedime, do t'i paraqiten nje kolegji  
arbitrazhi te perbere nga tre arbitra, prane dhomes se Tregtise  
Nderkombetare te Parisit ose Gjeneves, sipas procedures se tij.  
Ligji i zbatueshem do te jetë Kodi Civil Zvicerian(detyrime)

NENI 14

Dispozita te hollesishme per Shoqerine per-  
caktohen ne statutin e saj.

Kjo kontrate perpilohet ne dy ekzemplare ori-  
ginale ne gjuhen shqipe e angleze , duke marre secila pale nje  
ekzemplare.

CARRIGLEGAN LTD  
LIAISON OFFICE  
WALFISCHGASSE 14  
1010 WIEN

Per NTUS Nr3 Tirane/Shqipëri  
DREJTORE

Mimoza Lefgj

Tirane, me

17.12.1992

Per firmen "CARRIGLEGAM LIMITED"

Sonia Maya Castro

16/01/

GENERAL-INVEST  
HOTEL PEZA  
TIRANE, ALBANIA

7

1A

S T A T U T

3

I SHOQERISE SE PERBASHKET PER VEPRIMTARI  
EKONOMIKO-TREGTARE "GENERAL INVEST"

KAPITULLI I

EMERTIMI-OBJEKTI-SELIA-KOHEZGJATJA

NENI 1.

Eshte krijuar nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar me emertimin "GENERAL INVEST" SH.P.K.

Shoqeria eshte person juridik shqiptar ne baze te dekretit te ligjitNr 7638 dt 19.11.1992 per "shoqerite tregtare" dhe te ligjit Nr 7540 dt 04.08.1992 per investimet e huaja. Shoqeria gazon te drejten si person juridik shqiptar, duke filluar nga data kur organet kompetente shqiptare kane dhene miratimin e krijimit te saj.

NENI 2

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjistacionin shqiptar dhe ne dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj.(kontrat e statut)

NENI 3

*Deng*

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj ekonomiko-tregetare krijuesish ne fushen e sherbimeve tregtare per rikonstrukcionin e rrjetit tregtar ekzistues, shfrytezimin dhe sherbimin tregtar, dhe ngritjen e objekteve te rinj. Ajo do te zhvilloje ne Tirane e ne rrethe te tjera te vendit, rikonstrukcionin e objekteve tregtare, ngritjen e tyre ne nje kategori te larte, tregtimin e mallrave te konsumit te gjere, perfshire export-importin e trasaksi-one mallrash, sipas kerkeses se tregut shqiptar e et huaj, por mund te kryeje ne qofte se ka fitim dhe veprimtari te tjera.

4

Fillimisht shoqeria do te beje ndertimin,kompletimin e venien ne  
pune te objektit tre katesh ne rrugen e "Barrikadave"ne Tirane.

-----  
**NENI 4**  
-----

Pjesmarrja ne shqiperine e perbashket nuk i pengon ortaket te e  
kene panvaresi ligjore,organizative dhe te drejtat e pronesise  
jashte shoqerise.Ortaket nuk pergjigjen per detyrimet qe rrjedhin  
nga veprimtaria ekonomike-tregtare e shoqerise tej kapitalit the-  
melor te saj,ku ato kane marre pjese.Po keshtu shoqeria nuk per-  
gjigjet per detyrimet e ortakeve te saj jashte kesaj veprimta-  
rie.

-----  
**NENI 5**  
-----

Shoqeria e ka seline ne Tirane.Asamblea e shoqerise ka te drejte  
te krijoje ose te anulloje seli sekondare,filiale,agjensi dhe per  
faqesi pa kufizim territorial.

GT

IIA

-----  
**NENI 6**  
-----

Selia e ortakeve,per cka i takon raporteve te tyre me shoqerine  
per te gjitha efektet e ligjit,eshte ai qe rezulton nga libri i  
ortakeve.



-----  
**NENI 7**  
-----

Kohezgjatja e shoqerise eshte fiksuar per 30 vjet dhe mund te pri  
shet para afatit ose te zgjatet nje ose disa here me vendim te  
Asamblese se Ortakeve.

-----  
**NENI 8** KAPITALI  
-----

Kapitali eshte percaktuar ne dollar 205452\$USD ku pala "CARRIG-  
LEGAN" merr pjese me 60% dhe NTUSNr 3 me 40%.

-----  
**NENI 9**  
-----

NENI 9

Per arritjen e objektivave te shoqerise, te dy palet bien dakort te bashkojne kapitalet e tyre respektivisht, ne funksion te organizimit e te zhvillimit te veprimtarise se tyre te perbashket. Kapitali shoqeror i shoqerise se perbashket do te perbehet nga 205452\$USD nga te cilat 82181\$USD pala shqipetare dhe 123271\$USD pala e huaj.

- a) Pala shqiptare ose NTUS 3 do te marre pjese ne kapitalin shoqeror te themelimit ne masen 40% baraz me 82181\$USD e perbere nga vlera e rregjistruar nga inventari kontabel.
- b) Pala e huaj ose "CARRIGLEGAN LIMITED" do te marre pjese ne kapitalin shoqeror me nje kuote prej 60% e barabarte me 123271\$USD dhe perbehet nga para dhe ne natyre.

NENI 10

Ortak, me kerkesen e keshillit administrativ te shoqerise mund te zmadhojne kapitalin e shoqerise. Njekohesisht mund te zgogelojne kete kapital. Ne kete rast zgogelimi do behet ne perpjestim direkt me kontributin e ortakeve ne kapitalin social.

ZA  
LBANIA

NENI 11

Kuotat jane personale dhe nuk mund te jene kurre te perfaquesuara nga aksione, sipas nenit 45 te ligjit 7638/92.

Shoqeria do te leshoje nje certifikate secilit ortak qe verteton cilesine e tij si ortak dhe vlefthen e kuotes qe ai zoteron.

NENI 12

Te drejtat e bashkepronareve, per kuoten e pasurise se perbashket te me shume personave, duhet te ushtrohen nga nje perfaquesues i perbashket.

8

NENI 13

Ortaket, me kerkesen e organit administrativ te shoqerise, por unanimisht dhe ne propocion te drejte me kuotat qe zoterojne, mund te vene ne dispozicion te shoqerise, fonde te tjera ose mjete financiare ne llogari te kapitalit per te lejuar me mire arritjen e objektit shoqeror. Asamblea mund te vendosi here pas here kushtet e shlyerjes se ketyre shumave.

SI

NIA



NENI 14

e kapitalit shoqeror jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

NENI 15

Ortakebe i eshte rezervuar e drejta e parableries se kuotave ose te pjeses se kuotes se leshuar eventualisht nga ortaket. E drejta e parableries kur leshohet kuota e vet ose nje pjese e saj, duhet te zbatohet brenda 30 diteve nga data e njoftimit, te bere nepermjet letres rekomande te secilit prej ortakeve dhe vete shoqerise. Heqia dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e ortakut ndaj ortakut. Ne rastet kur e drejta e parableries te ortakeve ne blerien e kuotave nuk do te perdoret mbasi te kete kaluar afati i 30 diteve, keto kuota mund te afrohen te treteve qe nuk bejne pjese ne shoqeri ne menyre te parashikuar ne nenin 47 te ligjit 7638/92.

NENI 16

Transferimet e pjesave te kapitalit themelor, duhet te vertetohen me nje akt notarial. Shoqeria ose te tretet duhet te respektojne keto transferime sapo t'i behen te ditura asaj.

NENI 17

Derdhiet relative ne kuotat shoqerore kerkohen nga keshilli

administrativ ne afatin e ne menyren qe ai ka vendosur, duke per-  
caktuar penalitetet dhe sanksionet paraprake per vonesen.

### KAPITULLI III

#### ASAMBLEA

##### NENI 18

Organ i vendimor i shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve. Ne te marri  
pjese ortaket me te drejte vote sipas madhesise se shumave te  
vena per krijimin e kapitalit themelor te shoqerise.

Asamblea e Ortakeve vendos per bilancin vjetor per miratimin, per  
ndryshimet ne statut, per shtimin ose pakesimin e kapitalit theme-  
lor te shoqerise, per emerimin e organit administrativ, si dhe per  
pushimin apo rritjen e veprimtarise se shoqerise, percakton gjitha  
-shtu drejtimet kryesore te veprimtarise se shoqerise me shumice  
votash. Asamblea e Ortakeve te shoqerise thirret se paku nje here  
-nem, duke lajmeruar me shkrim 15 dite me perpara.

##### NENI 19

Organ i administrativ i shoqerise emerohet ose riemerohet ne fu-  
nkcionet e tyre nga Asamblea e Ortakeve sipas propozimit te or-  
takeve. Organ i administrativ perfaqeson shoqerine kundrejt te  
treteve brenda caqeve te objektit te veprimtarise se shoqerise,

**INVEST** perveç çeshtjeve qe duhet vendosur nga Asamblea e Ortakeve.

EZA

**BANIA**

##### NENI 20

Asamblea e zakonshme e ortakeve vendos rregullisht me voten e or-  
takeve qe perfaqesojne, me shume se gjysmen e kapitalit shoqeror  
per:

- a) Bilancin vjetor.
- b) Emerimin e keshillit administrativ.

c) Shperblimin e anetareve te keshillit administrativ.

Edhe neqoftese ortaket therriten ne mbledhjen e dyte, vendimet do te merren me voten e ortakeve qe perfaqesojne me shume se gjysmen e kapitalit shoqeror.

NENI 21

Organ i administrativ eshte kompetent per te marre vendime per:

- Te therrase Asamblene e Ortakeve me shkrim 15 dite perpara.
- Te miratoje planet dhe llogarite ekonomike mujore e tremujore, pas perpunimit te tyre ne kuadrin e objektit te shoqerise.
- Te propozuje emertesen e punimeve qe do te realizohen dhe te sherbimeve qe duhen kryer, per te marre vendim Asamblea e Ortakeve.
- Te beje propozimet e nevojshme ne Asamblene e Ortakeve per ndryshime ne kapitalin themelor te shoqerise ne rast nevoje.

  
Propozuje dokumentat normative qe perkufizojne raportet ne gjarigje shoqerise, duke perfshire edhe kuadrin e personelin per te vendosur Asamblea e Ortakeve.

Propozuje strukturen e aparatit te shoqerise.

**VESTA** Te propozuje dhe ndarien e vendet drejtuese ndermjet punonjesve te afte per kryerjen e kesaj pune.

**ANIA** -T'i paraqese Asamblese se Ortakeve propozime per rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve te vecanta, ndarien e fitimeve si dhe percaktimin e rregullave lidhur me shlyerjen e borxheve.  
-Te propozuje per krijimin e njesive strukturore si filiale, dege e perfaqesi per cedimin e veprimtarise se tyre ne perputhje me dispozitat ne Republiken e Shqiperise.

-Te pergartite propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqerise  
-Te parazgjedhe antaret e komisionit te likuidimit, te cilet emerohen dhe revokohen nga Asamblea e Ortakeve.

-Te propozuje per kerkimin e perdonimin e kredive afatgjate.

-Te siguroje zbatimin e perpike te vendimeve te Asamblese se Ortakeve.

NENI 22

Keshilli administrativ zgjedh ne gjirin e vet presidentin, zv/presidentin qe zevendetson presidentin ne raste te pengimit te tij si dhe nje sekretar qofte dhe te huaj.

NENI 23

Keshilli administrativ mblidhet si prepe selise se shoqerise, ashtu dhe diku tjeter te gjitha heret kur presidenti e gjuxon te nevojshme.

NENI 24

Keshilli administrativ thirret nga presidenti me njoftim te shkru pakten 7 dite para mbledhjes, per secilin administrator.



NENI 25

Met e keshillit administrativ do te quhen te vlefshme kur ja ne marre me shumicen e votave dhe me prezencen efektive te shufces se antareve.

NIA

NENI 26

Antaretee keshillit administrativ i perket nje shtese rroge vjetore e percaktuar nga Asamblea e ortakeve si she shlyerja e shpenzimeve per kryerjen e detyrave.

NENI 27

Asamblea e ortakeve ka mundesi t'i jape keshillit administrativ, me vendim perkates, nje sasi fondesh vjetore te vecanta per mbulimin e shpenzimeve te perfqaqesimit te saj kur ajo e shikon te arsyeshme e qe mbahen per llogari te shoqerise.

10

KAPITULLI IV

SHUARIA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

NENI 28

Shoqeria mund te prishet nga nje vendim i Asamblese se ortakeve me voten e ortakeve qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  e kapitalit shoqeror.

Raste te tjera te prishjes jane:

- a) Kalimi i afatit.
- b) Arritja e qellimit te shoqerise ose pamundesia per ta arritur ate.
- c) Pamundesia e funksionimit ose vazhdimi inaktiv i Asamblese.



Ne rast te tjera te parashikuara ne nenin Nr 72 dhe 38 te  
arritur ate.

NENI 29

Ne rastin e prishjes se parakohshme te shoqerise, antaret e keshillit administrativ, daten ne te cilin eshte vendosur shuaria marrin funksionet e pergjegjesite e likuidatoreve, me periashtim te rastit kur Asamblea e ortakeve vendos ndryshe.

INIA

NENI 30

Me emerimin e likuidatorit e te likuidatoreve pushojne funksionet e keshillit administrativ.

NENI 31

Likuiduesi ose likuiduesit, emerohen me vendim te Asamblese se ortakeve te marre me voten e ortakeve qe perfaqesojne shumicen e kapitalit shoqeror.

NENI 32

Kohezgjatja e mandatit te likuiduesit nuk mund te kaloje tre vjet

e mund te perseritet nga Asamblea e ortakeve me voten e ortakeve  
qe perfaqesojne shumicen e kapitalit shoqeror.

NENI 33

Likuiduesi, brenda gjashte muajve nga data e emertimit te tij,  
therret mbledhien e Asamblee se ortakeve, te ciles i paraqet ra-  
portin per gjendjen e aktivit e te pasivit te shoqerise para se  
te filloje operacionin e likuidimit.

NENI 34

Likuiduesi, perfaqeson shoqerine dhe ka te gjitha kompetencat e  
nevojshme per likuidimin e aktivit dhe pasivit te shoqerise para  
se te filloje operacionin e likuidimit.

NENI 35

Likuiduesi perfaqeson shoqerine dhe ka te gjitha kompetencat e  
nevojshme per likuidimin e aktivit dhe pasivit te shoqerise.  
Eshte i autorizuar te paguaj te gjithe kreditoret dhe t'iu  
shperndaje ortakeve te pricen ne dispozicion.

*JANIA*

NENI 36

Likuiduesi harton brenda tre muajve pas mbylljes se çdo viti fi-  
nanciar, llogarite vjetore, ne baze te inventarit mbi elementet e  
ndryshem te aktivit e te pasivit si dhe nje raport me shkrim mbi  
administrimin dhe mbi gjithe operacionin e likuidimit gjate ve-  
primtarise vjetore.

Asamblea e ortakeve vendos me voten e ortakeve qe perfaqesojne  
shumicen e kapitalit shoqeror.

NENI 37

Shperndarja e aktivit qe tepron mbas pagimit te ortakeve qe zote-  
rojne nga kapitali shoqeror, behet ndermjet ortakeve ne perpjestim  
te drejte me kontributin e tyre ne kapitalin shoqeror.

B

Neqoftese aktivi qe do te shperndahet ortakeve, perfaqesohet nga pasuri te palujtshme ose te drejta ose impiante si keto, do te proçedohet me shitjen me çmime te njejta me ato te tregut dhe te ardhurat do t'u shperndahen ortakeve ne perpjestim te drejte me kuotat e tyre te pjesmarrjes ne shoqeri.

KAPITULLI V

DISPOZITA TE TJERA

NENI 38

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin, do te zgjidhen ne mirekuptim, ne te kunderten do te zgjidhen nepermjet Arbitrazhit te Dhomes se Tregetise ne Paris, sipas rregullores se saj.

Ligji qe do te aplikohet do te jete ai zvicerian.

NENI 39

Per se qe nuk jane shprehur ne kete statut, duhet te behet referimi me dispozitat e ligjit ne fuqi.

EZA  
ALBANIA

NENI 40

Ky statut eshte hartuar ne tre kopje ne gjuhen shqipe e ne gjuhen Angleze qe kane vlore juridike te barabarte.

Per palen Shqiptare



CARRIGLEGAN LTD  
LIAISON OFFICE  
WALFISCHGASSE 14  
1010 WIEN

Per "CARRIGLEGAN LTD"  
GENERAL-INVEST

GENERAL-INVEST  
HOTEL PEZA  
TIRANE, ALBANIA